

ASPEKTE TË PËRDORIMIT TË KOHËVE TË FOLJES NË SHQIPEN E SOTME LETRARE

Tafil Kelmendi

Fakulteti Filozofik
Prishtinë

KUD 809.198.3—559
Punim studimor

Marrë në botim më 21 shtator 1987

Punimi kundron përdorimin e kohëve foljore të shqipes sipas dy tipave të ndryshëm ndërplotësues të *thëniezimit*: *ligjëratë/rrëfim*, ose, ndryshe, sipas dy *mënyrave të përshkrimit*: *përjetimor/historik*. Vend të veçantë zë funksionimi i kohës foljore në njësi më të mëdha se fjalia (e thjeshtë a e përbërë), në të ashtuquajturat *njësi jashtë-fjaliore, tejfjaliore* (transfrastike). Autori bën përpjekje të përcaktojë dhe të saktësojë mëtej kuptimet themelore të së kryerës dhe të kryerës së thjeshtë, të tërheqë kufijtë në kuptim midis tyre; në kuadër të çështjeve të mësipërme, punimi prek edhe anë të tjera të lidhura me përdorimin e kohëve foljore në shqipen e sotme letrare.

Koha është kategori deiktike që bën të mundur përndarjen e së tashmes, së shkuarës dhe së ardhmes. Me anë të saj lokalizohet në kohë fizikale procesi i emërtuar nga folja. Kategoria gramatikore e kohës është ndër çështjet e koklavitura të gjuhësisë. Koha dhe temporaliteti gjuhësor, shpërpjesëtimi, asimetria në mes të kohëve foljore të së shkuarës dhe të së ardhmes, koha foljore vështruar në gji të sistemit a nënsisteveme, koha foljore dhe tipi i *të thënit a i thëniezimit* (krh. fr. *énonciation*), koha foljore dhe temporaliteti, koha foljore dhe *aspektualiteti*, koha foljore dhe tekstorësia... janë probleme interesante, probleme që gjithnjë tërheqin vëmendjen e studiuesve. Gjuha shqipe cilësohet nga një sistem foljor i pasur dhe interesant, dhe kjo jo vetëm për sa i përket kategorisë gramatikore të kohës, por edhe kategorive të tjera, para së gjithash asaj të modalitetit.

Kohët foljore janë studiuar dhe vijojnë të studiohen me mjaft sukses në dritën e teorive të thëniezimit a të të thënit, themelues i të cilave, përveç Benvenistit, mund të merrej dhe R. Jakobsoni. Këto teori, para së gjithash, kanë të bëjnë me veçimin e rrëfimit (tregimit) nga ligjërata (diskursi), të kohës së thëniezimit nga koha e thënies, të subjektit të thëniezimit nga subjekti i thënies, të

vendit të thëniezimit nga vendi i thënies. Këto teori, në studimin e dukurive gjuhësore, marrin për bazë të ashtuquajturit angl. „shifters”, fr. „emrayeurs”, modalitetet, ligjëratën e lidhur, ligjëratën e zhdrejtë e të zhdrejtë të lirë, ligjëratën e çlirët.

Kohët foljore nuk përdoren vetëm për arsye të akëcilës vlerë kohore dhe/ose aspekte të synuar. Punimet e E. Benvenistit dhe të tjerëve tregojnë qartë se dëftorja është e zberthyeshme në dy sisteme të ndryshme kohësh foljore, të lidhura me dy tipa thëniezimi ndërplotësues të ndryshëm, njëri i quajtur „ligjëratë” („discours”), tjetri „rëfim” („histoire”, „récit”). Rëndësinë e veçimit të këtyre dy tipave e kanë miratuar gjerësisht Bull (1963); Weinrich (1964); Benveniste (1966); Ducrot & Todorov (1972) etj. Veçse, sa i përket kësaj çështjeje, nuk ka një terminologji të qëndrueshme, të njëjshme. J. Lyons-i i përdor përkitazi termat „historical” dhe „experiential”. Sipas tij, termi „historical” sugjeron rrëfimin e ngjarjeve të (për)renditura si suksesion dhe të paraqitura paanësisht me minimumin e pjesëmarrjes subjektive të folësit. Ky tip a mënyrë përshkrimi (angl. „the kind, or mode of description”) mund të lidhet qartë me konceptcionin statik, jodeiktik dhe objektiv të kohës kronologjike („kohë kronologjike” në vështrim të termit angl. „time”). Me termin „experiential”, nga ana tjetër, nënkuptohet tipi i përshkrimit që akëcili mund ta japë duke marrë pjesë vetë (personalisht) në atë që përshkruan; dhe ky tip nuk është më pak i lidhur qartë me konceptcionin dinamik, deiktik dhe subjektiv të kohës (kronologjike).¹

Ajo që e dallon ligjëratën nga rrëfimi është se e para lidhet me çastin e shqiptimit të thënies, ndërsa i dyti i ka të shkëputura lidhjet me atë çast.

Le të marrim këtë fragment nga „Ura me tri harqe”:

„Dhe unë i them këto tani që është ngrysur dhe horizonti nxin. Po shpejtoj të mbaroj kronikën time, sepse koha ecën tani mbrapsht, si gaforrja; edhe pak dhe ata mund të vërshojnë si një oqean i tërbuar dhe atëherë shkrimi i kronikave shqipe mund të paguhet me kokë. Dhe kjo kronikë, ashtu si ura vetë mund të kërkojë një fli, dhe këtu i flijuari s’ka kush të jetë, sepse unë, mungu Gjon, biri i Gjorg Ukcames, që e bëra atë tue kujtuom se në gluhen tonë ende s’ka gja të shkruom për Urën e Ujanës së Keqe dhe për mynxyrën që po vjen, dhe nsë dashunës botës sanë”.

Ky fragment përmban thënie shkrimore që kanë të bëjnë me ligjëratën (me diskursin). Thëniet e tij referojnë në kohën e thëniezimit, në çastin e shqiptimit të tyre; ato janë thënie që përmbajnë „shifters” dhe që janë të lidhura me aktualitetin e shqip-

¹ D. Maigueneau, *Approche de l'énonciation en linguistique française*, Hachette, Paris, 1981, f. 54; J. Lyons, *Sémantique linguistique*, Librairie Larousse, 1980, f. 309.

tuesit të tyre, duke mbajtur me të tashmen e tij një lidhje të gjallë.

Ligjërata ndryshon nga rrëfimi edhe në pikëpamje të modalizimit. Nuk është vetëm prania e të ashtuquajturve „*shifters*” tek e para dhe mungesa e tyre tek i dyti që i dallon ata: ata ndryshojnë prej njëri-tjetrit edhe në pikëpamje të mënyrës sesi folësi i qaset thënies së tij, sesi shqiptuesi ia hyn thënies që e sajón: *unë* e pranishme në ligjëratë është *unë* që merr mbi vete thënien.² Me fjalë të tjera, ligjërata si një nga tipat kryesorë të thëniesimit cilësohet nga gjurmë të shumta të kësaj marrjeje mbi vete, të kësaj qasjeje të folësit ndaj thënies. Është fjala për modalitete të ndryshme, si ngashërimor, afektiv, thirrmor...

Le të përimitojmë tash fragmentin tjetër:

„Oh, sa gëzohem kur më sjell kush ndonji ambëlsinë të mirë ose ndonji pemë, që *tashti* rrallë gjindet. Dje më kishte sjellë dajë Haxhiu një shegë. Më lëshoi goja lang kur e *pashë*, por nuk *mundesha* me e hangër, pse atëherë *këtu ndodhesh* xha Ceni dhe xha Meta...” („Sikur t’isha djallë”).

Vetori *unë*, ngërthyer në mbaresën vetore, që shënon shqiptuesin, e tashmja e çastit të ligjërit të thënies, deiktikët *këtu*, *tashti* dhe treguesi kohor *dje*, që lidhet drejtpërdrejt me kohën e thëniesimit, pasthirrma *oh* dhe fjala thirrmore *sa*, që bëjnë pjesë në thënien që hap fragmentin dhe që së toku pasqyrojnë drejtpërdrejt gjurmët emocionale, ngashërimore të shqiptuesit etj., — që të gjitha këto tregojnë qartë se fragmenti i mësipërm, marrë nga një ditar intim, ka të bëjë me ligjëratën. Edhe kohët foljore të së shkuarës nuk e shlyejnë praninë e thëniesit, por shprehin thjeshtë veprime parakohësie në lidhje me kohën e shqiptimit të thënies, veprime që janë të lidhura me aktualësinë e tyre.

Le të marim dhe një shembull:

„Pa thënë asgjë, Besiani *zbriti* i pari dhe i *dha* dorën së shoqes, për ta ndihmuar të zbriste dhe ajo. Me një kërcim të lehtë Diana *u hodh* në tokë. Pa e hequr dorën nga krahu i të shoqit, ajo *vështroi* në drejtim të hanit. Tre-katër njerëz *kishin arritur të dinin* që brenda dhe *po vështronin* gjithë kureshtje të porsaardhurit. Një tjetër, që *doli* i fundit nga porta e bujtinës, *u afrua* me një ecje shtrembaluqe” („Prilli i thyer”).

Ky fragment, sajuar mbi bazën e së kryerës së thjeshtë përmban thënie që nuk referojnë në kohën e thëniesimit. Këto thënie, pothuajse gjithnjë shkrimore, janë të zhveshura nga „*shifters*” të tillë si *ti*, e *tashme*, *tash*, *ky*, *kjo*, *këtu*...; ato janë të bashkëpajtueshme me *jovetën*. Kështu, rrëfimit, si tipi i dytë i thëniesimit, i përgjigjet në thënie një perspektivë tjetër në përjasje me ligjëratën: thëniet rrëfimore paraqesin një varg ngjarjesh të shkëputura nga shqiptuesi i tyre, shqiptues i cili s’lë gjurmë në to...

² Po ai, *po aty*, f. 55.

Në këtë rast, gjithçka vete thua se kurrkush nuk sajón thënie, sikur ngjarjet zhvillohen vetvetiu, thua se vetërrëfihen. Ndryshe nga *ligjërata*, që cilësohet nga gjurmë të mjafta të marrjes mbi vete të thënieve, *rrëfimi* përbën objektin e një dëftimi me modalizim „zero”; shqiptuesi i tyre shlyhet, ky nuk lë shenja në thëniet e veta. Pra, derisa në *ligjëratë* shqiptuesi është njëherazi *unë*-i që merr përsipër ligjërimin e vet, në *rrëfim* ai paraqitet si i papërcaktuar, si subjekt çfarëdo. Ky, në vend që të dëftejë (të asertojë), në të vërtetë kënaqet me të konstatuar.³

Pjesa më e madhe e thënieve gojore dhe shkrimore i përkasin ligjëratës, kurse rrëfimi ka të bëjë në radhë të parë me tekste rrëfimore të shkruara. Duhet të kihet parasysh që shlyerja e çdo shenje thëniesimi nënkupton nga shqiptuesi një kontroll të rreptë. Pavarësisht nga rëndësia e madhe e tij, veçimi ligjëratë: rrëfim, po qe se nuk kuptohet drejt, mund të na shpjerë në interpretime të gabueshme.⁴

Para së gjithash, „ligjëratën” a „mënyrën e përshkrimit eksperiencial” e cilëson prania e çiftit *unë/ti*, kurse të munguarit (joprانيا) e këtij çifti „rrëfimin”. Me anë të shenjës së barasvlerësisë, kjo mund të pasqyrohet kështu: *prania unë/ti* ↔ *ligjëratë*, *mungesa (paprania) unë/ti* ↔ *rrëfim*. Por, s’është vetëm *prania e jovetës* ajo që i vë themelet rrëfimit, as vetëm kombinimi „jovetë + e kryer e thjeshtë”. Në të vërtetë, për të qenë bartëse e rrëfimit, e kryera e thjeshtë e gjuhës sonë, për arsye të statusit të saj të dyfishtë, duhet të shoqërohet jo vetëm nga prania e jovetës, por, në një plan më të gjerë, edhe nga mosprania, mungimi i të ashtuquajturve angl. „shiftres”, fr. „embrayeurs”: *UNË: KËTU: TASH*.⁵ Në kombinim me jovetën, pra, aorisi i shqipes mund të jetë i

³ Po ai, *po aty*, f. 55; po ai *Analyse du discours*, Paris, 1976, f. 99—106. Shih dhe H. Weinrich, *Tempus*, Verlag W. Kohlhammer GmbH Stuttgart, 1964; përkth. fr. *Le temps, le récit et le commentaire*, Édition du Seuil, Paris 1973.

⁴ D. Maingueneau, *vep. e cit.*, f. 56—57.

⁵ Më imtësisht: R. Jakobson, *Essais de linguistique générale*, kap. 9, „Les embrayeurs, les catégories verbales et le verbe russe” (coll. „Points”); E. Benveniste, *Problèmes de linguistique générale* (Gallimard, 1966); shih ktp. XVIII „Structure de relations de personne dans le verbe” dhe kap. XX „La nature de pronom”.

Problèmes de linguistique générale II (Gallimard, 1974, kap. V: L’appareil formel de l’énonciation”.

Catherine Kerbrat — Oreccioni, *L’énonciation de la subjectivité dans le langage*, Armand Colin, Paris, 1980, bot. II 1984: „La problématique de l’énonciation” (kap. 1) dhe „De la subjectivité dans le langage: quelques-uns de ses lieux d’inscription” (kap. 2).

Për deiktikët kohorë, përveç të tjerësh dhe veprës së porsashënuar, J. Pinchon, „Problème de classification: les adverbes de temps” (*Langue française*, nr. 1, 1969); „L’homme dans la langue. L’expression de temps” (*Langue française*, nr. 21, 1974).

bashkëpajtueshëm qoftë me *rrëfimin*, qoftë me *ligjëratën*. Kjo del qartë e perceptueshme në atë rrëfim që ndërtohet mbi bazën e një situacioni komunikativ të gënjeshtërt dhe që krijon një realitet të rremë në shpirtin dhe në mendjen e lexuesit. Thëniet rrëfimore lozin rol të dyfishtë: ato bashkojnë botën reale në të cilën lexuesi ekziston, dhe botën imagjinare, në të cilën komunikimi zhvillohet (khs. *Langue, Discours, Société*, Paris, 1975, f. 285). Në rrëfim, i barasvlershëm ky me praninë e jovetës, me mungimin e dy vetave dhe të deiktikëve hapësinorë-kohorë, duket sikur rrëfimtari i gjithëdijshtëm percepton dhe shoqëron drejtpërsëdrejti veprimet dhe lëvizjet... e personazheve; thua se ai është njëfarë vëzhguesi dhe riprodhuesi i padukshëm, por i pandërmjetshëm i ngjarjeve, i ndodhive...; në këtë rast te folja në kohën e shkuar të rrëfimit thua se „fshihet”, „shlyhet”, birret domethënia e kohës së shkuar (në vështrim të kohës kronologjike). Ky funksion në rrëfim para së gjithash realizohet nga e kryera e thjeshtë, e prirur për të shprehur konsekuencat e situacioneve, për konstatimin e kryerjes së tyre njëri pas tjetrit (termi „situacion” në këtë punim përmbledh nocionet „veprim”, „ngjarje”, „proces”, „gjendje” etj.).

Ndërsa kombinimi „jovetë + e kryer”, edhe në mungesë të çifitit *unë/ti* në mënyrë të vetvetishme shpie në *ligjëratë*, ose, ndryshe në planin e *përjetimit* të të thënit, kombinimi „jovetë + e kryer e thjeshtë”, marrë në vetvete, në mënyrë të veçuar, nuk është „i mjaftueshëm” për të lidhur thënien me njërin ose tjetrin plan thëniezimi. Ajo, që, mbi të gjitha, të kryerën e thjeshtë të gjuhës sonë e bën bartëse të statusit të kohës së *rrëfimit* ose të *ligjëratës* është vetë tipi i situacionit kumtesor, bota e situacionit komunikativ, në njërin anë, tipi, përkatësisht bota kumtesore e gënjeshtërt (imagjinare), në anën tjetër, tipi, përkatësisht bota komunikative reale (aktuale). Si bartëse e statusit të kohës së rrëfimit, e kryera e thjeshtë shpërndahet në një rrethinë të cilësuar nga mungimi a paprania e vetave *unë/ti*, ndërkaq, si bartëse e statusit të kohës së *ligjëratës*, ajo përndahet në një rrethinë, të karakterizuar nga prania e vetave *unë/ti*. Kështu, një thënie me kombinim „jovetë + e kryer e thjeshtë” si: „Stresi *vizitoi* zonjën plakë dhe të bijën e saj, Doruntinën”, si e tillë, e veçuar nga situacioni komunikativ, e marrë në vetvete, pa kontekst, në pikëpamje të tipit të thëniezimit a përshkrimit, mbetet e papërcaktuar; kjo madje më parë mund të interpretoj si thënie e *ligjëratës* sesa e *rrëfimit*. Ndryshe ngjet në gjuhë si frëngjishtja, ku një kombinim i tillë shpie vetëm në rrëfim. Por ndryshe ndodh me kombinimin „jovetë + e kryer”, si: „Stresi *ka vizituar* zonjën plakë dhe të bijën e saj, Doruntinën”, e cila, edhe jashtë vetave *unë/ti*, çon në tipin e *ligjëratës*, meqë kjo kohë foljore, siç u përmend, përkundër së kryerës së thjeshtë, funksionon vetëm brenda tipit të *ligjëratës* (me përjashtim të teksteve që shfrytëzojnë burimet gjuhësore jashtë sferës së ndërkëmbimeve të zakonshme foljore). Por, po

qe se thëniet e mësipërme gjymtyrëzohen me deiktikun *dje*, atëherë është deiktiku *dje* që, në rastin e parë, edhe pa veta, thënien me folje në të kryerën e thjeshtë e vë në lidhje me aktualësinë e shqiptuesit të saj; në rastin e dytë, e kryera dhe deiktiku *dje* së toku, edhe pa veta, bashkëshprehin lidhjen e thënies me tashmësinë e shqiptuesit. Pra, në të dy përdorimet, deiktiku *dje* (me referencë T_0), veç të tjerash, është tregues i qartë i referimit të thënies në të tashmen e thëniesimit. Kështu, pra, në rrëfim joveta nuk ka po atë status që ka në ligjëratë: në rastin e parë ajo më tepër është mungim i vetës sesa jovetë, kurse në të dytin ajo u kundërvihet qartë dy „vetave”.⁶

Midis kohëve foljore, e kryera e thjeshtë dhe e kryera, si kohë perfekte, përkufizimi dhe përcaktimi i vlrave të tyre kuptimore, tërheqja e caqeve më të qarta në përdorim dhe bashkëlidhja e tyre në rrjeta të ndërliqshme ligjërimore, paraqesin njëherazi problem dhe interes për sistemin foljor të gjuhës sonë. E kryera e thjeshtë, që aq sa është kohë e rrëfimit, po aq dhe e ligjëratës, sajton kundërvënie me të pakryerën, në planin *aspekt i kryer: aspekt i pakryer*, edhe në rrëfim, edhe në ligjëratë. Ndërsa e kryera e thjeshtë shpreh vetëm veprim të mbaruar, e pakryera situacionin e paraqet me kufij kohorë të pacaktuar. Kjo gjithmonë ndien nevojë për tregues kohor të shprehur kontekstualisht dhe këtë kërkesë të saj e përmbush rëndom e kryera e thjeshtë, e cila në natyrën e saj e mbart mundësinë e lokalizimit të veprimit në kohë, të datimit objektiv, duke dalë në njëfarë mënyre në marrëdhënie me vetveten dhe jo në marrëdhënie me një shenjë kohore. Duke u përdorur bashkërisht, e kryera e thjeshtë dhe e pakryera krijojnë solidarësi funksionale, shfaqur kjo sidomos në thënie që kanë të bëjnë me incidencë, me të ashtuquajturën „skemë incidence”: „*Një mbasdite, tek po kthehej për në shtëpi, Stresi, pa e ditur as vetë pse, e ktheu kalin nëpër rrugën që çonte në ki shë*”. Format e së pakryerës, duke e shprehur veprimin në të shtjelluar, ndërtojnë sfondin, bazën në të cilën bie „pika” e incidencës, dhënë nga folja perfekte. Por e kryera e thjeshtë nuk hyn në bashkëlidhje vetëm me të pakryerën; ndryshe nga kundërvënia me këtë, që shfaqet edhe në rrëfim, edhe në ligjëratë, kundërvënia e saj me të kryerën funksionon vetëm në ligjëratë. E kryera, pra, është kohë tipike e ligjëratës, dhe kjo nuk ka si të mos merret si një e dhënë me rëndësi në përcaktimin, saktësimin dhe përkufizimin e kuptimit dhe të natyrës kohore-aspektore të saj. E kryera e thjeshtë merr pjesë paralelisht në të dy tipat e të thënit: dalja e saj në tipin e *përshkrimit eksperiencial (përpyjetimor)* a *diskurs (ligjëratë)* është po aq e rëndomtë, sa edhe e së kryerës, secila me përdorim përkatës. Dallimi ndërmjet tyre në ligjëratë nuk është i lehtë për t’u tëfilluar. Që të dy këto kohë janë deik-

⁶ D. Maingueneau, *vep. e cit.*, f. 15, 57, 58.

tike: shenjë përcaktimi e marrëdhënies së tyre është koha e thëniezimit; që të dyja mund të bashkëpërdoren (bashkëpajtohen) jo vetëm me treguesin kohor *dje*, por edhe me treguesin *tash* (në ligjërime popullore kjo është më e rëndomtë). Këta rrethanorë saktësojnë vendin e pikës referenciale *R*; ata modifikojnë këtë pikë, qoftë parakohore, qoftë bashkëpërkuese (e njëkohshme) me kohën e të thënit (*S*). Pra, sa i përket shqipes, që të dyja këto 'kohë' bashkëpajtojnë me deiktikun *dje*, si ngërthyes i pikës *R*, parakohore me *S* dhe, cila më shumë, cila më pak, edhe me deiktikun *tash*, si përfshirës i pikës *R*, bashkëpërkuese (e njëkohshme) në këtë rast me pikën *S*. Në gjuhën shqipe, në kombinimin e këtyre 'kohëve' me deiktikun *dje* nuk paraqitet farë shtrëngese: që të dyja janë të hapura në këtë lojë kombinimi. Kështu, duke përdorur sistemin referencial të *H. Reichenbach-ut* (1966) (*Elements of symbolic logic*, New York/London, orig.: 1947, cit. sipas *Co Vet, Temps, aspects et adverbess de temps en français contemporain*, Genève, Librairie Droz 1980; khs. dhe *Le temps gramatical, logiques temporelles et analyse linguistique* par *R. Martin & F. Nef*, Languages, N° 64, Larousse 1981), në njërin rast do të kishim të bënim me *ER-S*, ngjarja (*E*) dhe pikëreferimi (*R*) bashkëpërkujnë dhe janë në raporte parakohësie në lidhje me kohën e shqiptimit të thënies (*S*), në të dytin *E-RS*, ngjarja (*E*) është parakohore në marrëdhënie me pikorientimin (*R*) dhe kohën e shqiptimit (*S*), të cilat bashkëpërkujnë. Marrja e kohës së ngjarjes ose e një *atëherë* (një si burim a pikënisje kohore struktur në thellësi në të shkuarën) si shenjë përcaktimi të marrëdhënies kohore të këtyre dy 'kohëve' do të shpinte në ngatërrimin e vlerës së vetë formës dhe të sistemit të referencës që e përcakton atë. Në pikë të fundit, informacioni i dhënë nga e kryera e thjeshtë dhe e kryera e gjuhës sonë është ky: situacioni i emërtuar nga folja ndodh në një kohë përpara kohës së të thënit. Do të duhej parë mirë edhe se cila nga të dy kohët në shqyrtim e ka më shumë e cila më pak të shprehur referencën deiktike. Dy 'kohët' në shqyrtim dallojnë, në planin e përgjithshëm përdorimor, në pikëpamje të pranisë, përkatësisht të mungesës së komponentit të zgjatimit (me kufij të caktuar kohorë), të intervalit, të shtrirjes ose jo në kohë të veprimeve të përfunduara, të zgjatjes, gjegjësisht të moszgjatjes në kohë të tyre. Në përgjithësi, me të kryerën e thjeshtë konstatohet përfundimi i veprimit, perceptuar si një e tërë e njësishe, gjithë shtjellimi i të cilit kapet si pikë e dalë në një çast mirë të përcaktuar. Pavarësisht nga përdorimi, absolut a relativ, në ligjëratë a rrëfim, veprimi i shënuar nga kjo jepet si një veprim pikësor, i menjëhershëm, i fiksuar dhe i përmbyllur si një pikë, zënë në fundin, por edhe në fillin e tij. Sa i përket kundrimin të veprimit si të përcaktuar a të papërcaktuar, e kryera sillet disi asnjësisht, indiferentisht. Pikërisht në paraqitjen e veprimit si gjendje e përfituar nga kryerja e tij a si njëfarë zgjatjeje

(megjithatë me kufij kohorë të caktuar), në njërën anë, apo në konstatimin e përfundimit të veprimit, në dhënien e tij si të çastit, pikësor, momentan, të menjëhershëm, të përcaktuar mirë nga e kryera e thjeshtë, në anën tjetër, — në këtë qëndron dallimi thelbësor ndërmjet tyre. Përdorimi themelor i së kryerës së thjeshtë ka të bëjë me paraqitjen e një situacioni dinamik si ndodhi, si një ngjarje. Kështu pra, e kryera e thjeshtë, në kuptimin e parë, lidhet me ngjarje që ndodhin si pika kohore të përcaktuara, kurse e kryera me procese që zgjatin njëfarë periode kohore, ose me gjendje të dala nga veprime të kryera; kjo veprimin e përfunduar e kap gjatë gjithë fazave të shtjellimit, në një zgjatje realitive, në një shtrirje me kufij kohorë të përcaktuar (determinimi është pasojë e veprimit të kryer). E kryera e thjeshtë shpesh përkufizohet si kohë veprimesh të përfunduara konsektive ose si kohë rrëfimore, ndërsa e kryera si kohë që shpreh qoftë veprim të vlefshëm në një çast parakohor në lidhje me kohën e të thënit, qoftë gjendje të dalë nga veprimi i kryer, e vlefshme në atë çast, ose, që e kryera shpreh veprim në të shkuarën ose gjendje në të tashmen. Kjo dysi kuptimore e së kryerës lidhet me „situacionin” me të cilin ka të bëjë thënia e dhënë. Përdorimi i njërës ose i tjetrës kohë foljore varet dhe nga kuptimi leksikor i vetë foljes, nga mënyra e veprimit, nga „aftësia” e njërës, përkatësisht „paaf-tësia” e tjetrës kohë për të mbartur kuptimin e gjendjes së veprimit të kryer. Në varësi nga konteksti gjuhësor, nga mënyra e veprimit të foljes, nga rrethanat e shqiptimit të thënies... , e kryera mund të tregojë përsëritje, rëndomësi veprimesh, supozim... ; jo rrallë folësi nëpërmjet saj sikur nga veprimi i kryer aktualizon cilësinë, shprehinë, „preokupimin” gjegjës të objektit (kjo lidhet përgjithësisht me kuptimin e gjendjes). (1) *Çaji është zier*. (2) — *Çaji u zie*. Në (1), nga procesi tashmë i përfunduar nxirret gjendja e tij në të tashmen; në (2) nuk synohet, as perceptohet gjendja (që është implicite), por, para së gjithash (në ligjëratë) përfundimi i pandërmjetshëm i veprimit në lidhje me çastin e thëniezimit; konstatohet kryerja e tij e perceptuar si një e tërë e pandashme, e njësishe, e pazbërthyeshe dhe e zënë në cakun fundor ose në cakun fillues. Në dallimet në përdorim të njërës ose të tjetrës kohë, nuk është asnjë *tipi i situacionit*, — termi „situacion” këtu përmbledh nocionet e „ngjarjes”, të „veprimit”, të „procesit”, të „gjendjes” etj., — tipi transicional (i kalimësisë) dhe tipi jo-transicional (i jokolimësisë), dhe në gji të të parit foljet e procesit dhe të veprim-procesit, kurse të të dytit foljet e gjendjes, të pozicioneve, të aktivitetit dhe të dinamizmit. Brenda secilit nëntip duan parë dhe komponentët (+kalim); (+veprues); (+kontroll); (+rastësi); (+dinamizëm); (+linear); (+çastësi). Venerimi nga kjo anë e trajtave foljore, duke paraqitur interes të veçantë, sidomos sa i përket aspektualitetit, duhet të jetë njëra nga detyrat e gjuhësisë sonë të sotme.

Kuptimi i gjendjes tek e kryera del i theksuar veçanërisht kur kjo shoqërohet nga e tashmja me aspekt të pakryer; në këtë rast, pikëreferenca nga caktohet marrëdhënia kohore e të dy kohëve është po ajo: — Shoku Gjergj! Një fshatar *ka ardhur* e ju *kërkon*; „O *ka dalë* dielli e *flet* me malet / e hana *qesh* me retë...”; — Madhëri, populli *asht ngritë* në kambë e *po bërtet* e *po shan* sa po mundet; — Vë re se është malësori që *ka nxjerrë* nga xhepi një radhua të vogël e diç *po shkruan*; I *kanë rënë* në erë punës. *Kanë ulur* qepenat dhe *rrinë* brenda — tha Idajeti.

Një dallim tjetër ndërmjet këtyre dy kohëve të foljes qëndron në „largesën”, „distancën” e të treguarit të veprimit të kryer në varësi me kohën e shqiptimit të thënies: — Unë *kisha njohur* shumë vajza, por përshtypjen dhe gjendjen shpirtërore që më *krijoi* kjo vajzë, s’ma *ka krijuar* asnjë tjetër; — Siç ju *kam thënë* edhe më parë dhe siç jua *përsërita* edhe *dje*, nga hulumtimi i arkivit unë *kam nxjerrë* një përfundim që është krejt i ndryshëm nga ajo që thuhet apo hamendësohet për ngjarjen enigmatike. Në gji të kësaj „distance” është për të përmendur të shprehurit nga aoristi i një situacioni të porsapërfunduar, të pandërmjetshëm në lidhje me kohën e thëniesimit. Në këtë përdorim e kryera e thjeshtë shoqërohet me mjete leksikore të pandërmjetësisë kohore: *porsa*, *posa*, *sapo*, *sa*, *(qe)sa*, *(ja)sa*. Në rast të joshoqërimit nga të tilla mjete, funksioni përcaktohet nga rrethanat ligjërimore. Duke qenë kohë e situacioneve të çastit, momentane, të menjëhershme, kohë e konstatimit të përfundimit të veprimeve, ajo „mbart në vetvete” dhe aftësinë e shprehjes së të papriturës së folësit për çka kumtohet në kohën e thëniesimit. Shemb. — Ku *the* ke punuar?; — Jua *thashë*: *ka mbërritur* mbrëmë në rrethana krejtësisht misterioze; — Pak më parë diçka më *the* për tronditjen e tyre; — Ohooo, kush na *erdhi!* — Ja e *kreva*; — Ja, e *kapërceu* qafën e malit; — Sapo *mora vesh* që keni ardhur; — E *gjeta* më në fund, — tha murgu, — flasin një gjermanishte të përzier me sllavishten; — Po desha të di nëse ju e keni fjalën për ngjarjen për të cilën *porsa folëm*; (— Ju ç’do të bëni?) — Ne do të nisemi menjëherë andej nga *erdhëm*, — u përgjegj tjetri; — Të *solla* ca të holla, *erdha* të të ndihmoj; (— Mund të kesh probleme në qoftë se i mvësh akuzën.) — Kush e *përmendi* akuzën?; (Le të rrihen, mos ndërhyr!) — E *thirrën* policinë; — Meqë *ra* fjala, ku është ajo? — Mirëmbërëma, *mirë se na erdhët* në koncertin tonë të sotëm!; — Ç’*pate*? Ç’*të gjeti*?; — Pikërisht, — tha ndihmësi, — një zbulim... Kjo lidhet tamam me atë dyshimin tim... që ju *fola* pak më parë; — Ç’*të bëjmë*? Municioni na u sos.

Parakohësi të pandërmjetshme të situacionit shpreh dhe e varura kohore prirë nga lidhëzat *posa*, *porsa*, *sapo*, *për një që*, *sa*... Shemb. — E pohoi, lavdi zotit, — tha ai. — Sapo *pa veglat* e *torturës*, e pohoi menjëherë. *Posa shkela këmbën këtu*, *posa më dëgjuat emrin*, rendët të gjithë; *Për një që vuni kambën n’anë të tij*,

kapi shpatën e Baca Filarit; *Porsa pa ujku q'u ndanë qetë*, armikut iu hodh me të vërtetë. Në këto raste fakti i fjalisë drejtuese ndodh menjëherë, sapo ndodh ai i fjalisë së varur kohore. Është fjala për rendin e suksesiviteteve të pandërmjetme në fjalinë e përbërë kohore. Në përcaktimin e marrëdhënies kohore ndërmjet pjesëve të fjalisë së përbërë kohore, disa gramatikanë nisen nga fjalia e varur, të tjerët nga drejtuesja. Kur fjalia drejtuese (a) dhe fjalia e varur (b) nuk shprehin njëkohësi, atëherë parakohësia ose paskohësia e njërës në raport me tjetrën do të shërbejë për të përcaktuar relacionin e bashkimit të së varurës me drejtuesen. Në qoftë se e nënrenditura merret si referencë e përcaktimit të kohës së drejtueses, atëherë procesi i së varurës do të jetë ai që tregon parakohësi ose paskohësi, duke marrë parasysh rendin kronologjik në të cilin prodhohet, përpara ose pas procesit të drejtueses.

Veprimi mund të shtrihet deri në kohën e thëniezimit, dhe kështu e kryera e thjeshtë të tregojë bashkëpërkim të veprimit me kohën e shqiptimit të thënies: — *Ika* që këtej = *Po iki* që këtej (shqiptuesi e shoqëron thënien me veprimin e tij); — Gjykimi *mbaroi*; Me kaq, mbledhja *mori fund*; Me këtë pikë, tubimi ynë përfundoi. Shikues të dashur, emisioni ynë *mori fund*; *Ndoqët* ditarin tonë të dytë.

Në përdorimin e veprimeve të porsapërfunduara në lidhje me kohën e thëniezimit, sikur përkojnë pjesërisht aoristi i shqipes dhe *passé recent* (*passé immédiat*) i frëngjishtes; me të ngjajnë, si dhe në disa pika të tjera, edhe aoristi i të folmeve serbe, mala-zeze, boshnjake. . . në kontakt e në kufij me shqipen, si dhe përdorimi i aoristit në maqedonishte.

Duke qenë kohë e cila situacionet e vendosura në të shkuarën i pasqyron si pika të fiksuara, të përcaktuara e konkrete, të çastit e të përmbledhura, kapur në fundin apo në fillimin e tyre, e kryera e thjeshtë, si rrjedhim, në vetvete ka brumosur aftësinë e dhënies së situacioneve në varg, në pasim të njëri-tjetrit, në suksesivitet të pandërmjetshëm, — mundësinë e kallëzimit a të kumtimit të ngjarjeve sipas një rendi të caktuar të zhvillimit të tyre, ashtu siç kanë ndodhur realisht ose do të kishin mundur të ndodhnin. Si rregull, situacionet që pasojnë njëri-tjetrit në tekst a në ligjërim interpretohen ashtu siç pasohen në realitet, objektivisht. *Khs. Ai doli nga zyra dhe vuri kësulën / Ai vuri kësulën dhe doli nga zyra*. Por veprimet e dhëna në varg, në pasim të njëri-tjetrit në tekst, nuk duan kundruar mekanikisht, si riprodhim i thjeshtë, si suksesivitet i rreptë dukurish të realitetit, si kalke situacionesh të natyrës. E kryera e thjeshtë thua se është „specializuar” (edhe) si kohë e kallëzimit a e kumtimit të ngjarjeve, të përjetuara e të dëshmuara personalisht nga emetuesi ose të paraqitura si të tilla. Këtë tipar (komponent) ajo për bart jo vetëm në diskurs, por edhe në rrëfimin e mirëfilltë. Ky tip i të kumtuarit priret në

dhënien e konsekuencave të situacioneve; ai synon vetëm konstati-min e kryerjes së tyre sipas një radhe të caktuar, dhe, siç u tha, ky funksion realizohet para së gjithash nga e kryera e thjeshtë. Nga e kryera situacionet do të dilnin (ose dalin) të çlirëta e të veçuara; kjo nuk mbërrin t'i pasqyrojë ato të bashkërenduara, dinamike, ekonomike, por, përkundrazi, disi të shpërndara, të he dhura „dosido”, të pasistemuara, pa (për)renditjen dhe rregullsinë e rreptë dhe të tendosur, në të cilat i jep e kryera e thjeshtë. Ndërkëmbimi i tyre do të kishte si pasojë edhe një përpjekje për një si zhvendosje të mendjes e të qenies së „emetuesit” e të recep-tuesit nga situacioni komunikativ aktual në një situacion kum-tesor joaktual, imagjinar apo, nëse mund të themi, nga bota ak-tuale në botën e mundshme; përveç ndërrimit të planit të të thë-nit, të llojit të situacionit kumtesor, ndërkëmbimi mund të jetë shfrytëzuar si njëfarë ecurie ndërtimi e tekstit letrar, duke bërë që rrëfimi të duket si kinse — ligjëratë; ky ndërkëmbim do të kishte si rrjedhojë shprehjen apo mosshprehjen e gjendjes. Shemb.: (— Po të dëgjoj, — përsëriti ai. — Si është puna?) — Një të diel, jo këtë që *shkoi*, as tjetrën, por para kësaj, Zonja Mëmë *erdhi*, sipas zakonit, në varrezë, për të ndezur nga një qiri mbi varrin e çdo djali. . . Po, zoti Stres. Ajo *ndezi* nga një qiri mbi çdo varr, kurse mbi varrin e Kostandinit *ndezi* dy qirinj. *Qëllova* aty pranë kur *ndodhi* kjo dhe *dëgjova* ç’tha ajo aty te koka e va-rrit. (— Po dëgjo të të tregoj, se të gjitha i kam parë me sytë e mi, — tha Demiri. — Ky shkëmb na ka mbërthyer keq. Edhe më parë kemi hequr nga ai.) Në hijen e tij *mërzenin* dhitë, po, kur *nisi* lufta me grekun, *erdhi* xhenioja italiane dhe i *hapi* frëngjitë. E *gërmuan* shkëmbin nga brenda me dinamit dhe natë-ditë *nxirr-nin* gurë e baltë me ca vagona. Kur *mbaruan* shkëmbin, *hapën* hendeqe rreth e qark sheshit të lartë. Bënë kala, e bënë. Pastaj *erdhi* një gjeneral. *U rrethua* vendi me tela me gjemba dhe *varën* ca dërrasa me kafkë të vdekuri dhe me kryq. Kur *erdhi* greku, Italia *u mbajt* lart, në Qafë. *U grinë* e *u therën* me mijëra tërë dimrin. Pa po ku thërriste greku së këtejmi „epese to Tepeleni”, ia ndizte shkëmbi me zjarr në tym dhe u binte tufave me dhi, nje-rëzve, si një i dehur që shan pa dallim gjithë udhëtarët. Kur *u praps* fronti, në shkëmb *mbetën* vetëm dy roje. *U nguros* i prapi. Në frëngji *i mbinë* fiq të egër. Dhitë *u ngjitën* prapë lart. (E ki-shim nxjerrë nga mendja këtë shkëmb, gjer aty e tre muaj më parë. Tani filloi prapë si i xhindosur. Nuk duron të lëvizë as miza përgjatë lumit. Ka hapur varre anës rrugës, se populli venë për bukë. Ka prerë rrugën e njerëzisë. Ja këto punon ky Shkëmb i Malit).

Ky lloj thëniezimi, megjithëqë shfrytëzon rekuizitat e rrëfi-mit, si të kryerën e thjeshtë dhe mungesën e deiktikëve hapësi-norë-kohorë, lidhet me ligjëratën; veta rrëfyese është shqiptues aktual; në këso rastesh sikur kemi një farë rrëfimi të ligjëruar,

rrëfim-ligjëratë ose, anasjelltas, njëlloj ligjërata rrëfyese, ligjërata të rrëfimëzuar. Vetë shqiptuesi a autori atë që kumtohet, e quan „tregim”. Në fragmentet e mësipërme, prania e dy vetave (përkitazi „tregues”; „dëgjues”) përbën „sferën e ligjërimit”, ligjërimit që çon në një botë të jashtme, në botën e jovetës në kundërvënie me vetat e shkëmbimit gjuhësor. Në këto fragmente, joveta u kundërvihet qartë dy vetave. Mungesa e deiktikëve dhe shoqërimi i jovetës (që përbën objektin e të folurit) nga e kryera e thjeshtë, sikur lexuesin e zhytur në fillin e ngjarjes e bëjnë „të harrojë” praninë e vetave në kundërvënie me jovetën dhe të pandehë sikur teksti shoqërohet nga mungesa e dy vetave dhe nga prania e jovetës rrëfimore, e ndryshme nga joveta që përfaqëson botën për të cilën kumtojnë *unë:ti*.

Një dallim tjetër i rëndësishëm, është dhe tipari i *dëshmimësisë*, — aftësia e së kryerës së thjeshtë për të „mbartur” praninë e folësit në situacionin e kumtuar. Ndërkëmbimi i së kryerës (e cila nga kjo pikëpamje sikur është asnjënjëse) nga e kryera e thjeshtë thua se i „shton” situacionit të kumtuar komponentin e dëshmimësisë, tiparin e pranisë së shqiptuesit në çka referon brendia e thënies. Ky komponent shfaqet edhe në gjuhë të tjera të Ballkanit, si në maqedonishte, bullgarishte, në të folme serbe, malazeze, boshnjake. . .

Vetë fakti i gjëllimit të aoristit dhe të imperfektit sidomos në dialekte e të folme serbe në kufij e në kontakt me shqipen dhe përdorimi i kufizuar i tyre në dialekte e të folme jashtë këtyre zoneve, si dhe në gjuhën letrare serbokroate, krijon përshtypjen se gjuha shqipe, e cila gjithandej i përdor atë që dendur këto kohë foljore, mund të ketë ndikuar të paktën në ruajtjen, në konservimin e tyre në ato dialekte e të folme.

Funksionimi i kohëve foljore nuk kufizohet në caqet e fjalisë⁷ (termi *fjali* në këtë rast parakupton dhe *fjalinë e përbërë, periudhën*); kohët foljore funksionojnë edhe në gji njësisht jashtë-fjalioare, tejfjalioare, transfrastike; përveç funksionit deiktik dhe ecurive të ndryshme në thëniesim, që mund të bartin, ato shpesh luajnë një rol me shumë rëndësi në strukturimin e teksteve, — me vendin që zënë në to, me përsëritjen e tyre, si dhe me ndërriemet a kalimet nga një kohë foljore në një tjetër.⁸ Funksionimi i kohëve foljore në kuadër tekstoral del mjaft i qartë sidomos në të ashtuquajturën ecuri relievizimi a të vëni në pah, në përdorimin e tyre ndërplotësues përkitazi *perfektiv: imperfektiv*, si kohë të *planit të parë* e të *planit të dytë*. Në këtë rast kemi të bëjmë me çështje që i përkasin gjuhësisë tekstuale.

⁷ Rëndësinë e funksionimit të kohëve foljore në kuadër tekstoral e ka vënë në dukje dhe R. Ismajli: *Shumësia e tekstit*, Rilindja, Prishtinë, 1977.

⁸ D. Maingueneau, *vep e cit.*, f. 64, 66, 68, 86.

Le të përimitojmë një fragment, të lidhur me rrëfimin, nga romani „Lëkura e daulles”:

„*Ishte mesditë. Zhegu të digjte. Ai eci me shpejtësi përmes fshatit dhe doli matanë udhës, atje ku fillonin arat. U fsheh në grurë dhe priti. Përreth këndonin gjinkallat. Bota dukej si e topitur nga vapa. Kallëzat e grurit e ngacmonin pa pushim në vesh, në qafë, në ballin e djersitur. Ai i largonte me nervozizëm. Priti kështu dy orë. Më në fund, njeriu që duhej të vdiste, kaloi. Ecte me armën në sup, me hapa të gjatë e të shkathët. Ai ngriti pushkën, mënjanoi me tytë disa kallëza (ishte ndërhyrja e fundit e grurit). Në shënjestër u fut koka e njeriut. Ndali frymëmarrjen dhe shtiu. Flaka përzhiti kallinjte e grurit. Njeriu u rrëzua përmbys”.*

Shihet qartë se e ashtuquajtura „skemë incidence” nuk mbyllet në kufij të fjalisë, por vepron jashtë saj, duke luajtur rol të rëndësishëm në organizimin e tekstit e duke tejkaluar në këtë mënyrë perspektivën thjesht aspektore: *kryersi: pakryersi*. Në këtë fragment shprehet mjaft qartë kundërvënia e kohëve foljore të „veprimit” dhe të „përshkrimit”; e kryera e thjeshtë dhe e pakryera e kapërcejnë perspektivën aspektore në komplementarësi, duke ndjekur rrëfimi në këtë rast sistematikisht ecurinë e relievizimit, me grupëzimin në vargje homogjene të trajtave foljore kohore, në njëerën anë kohët foljore në të kryerën e thjeshtë, në anën tjetër kohët foljore në të pakryerën. Tani, mbi perspektivën aspektore *kryesi: pakryesi* mbishtrohet komplementarësia në mes vargjeve në kundërvënie, duke sajuar këto njësi tekstore koherente në gji të tërësisë rrëfimore dhe duke marrë vlera të rëndësishme në ndërtimin (strukturimin) e tyre. Trajtat foljore kohore perfekte, dhënë nga e kryera e thjeshtë, paraqesin dinamizmin, gjallërinë e veprimeve suksesive të rrëfimit, duke e lëvizur, duke e çuar më tej, duke e përparuar atë; përkundrazi, trajtat me *-(n)te* e ndalin rrëfimin, e frenojnë në dobi të përshkrimit, për të dhënë, në përçasje me dinamizmin, gjithë ç’është statike. Trajtat me *-(n)te* ndërtojnë pikturën, tablonë, sfondin ku kryhen veprimet, të dhëna me të kryerën e thjeshtë. Sajohet kështu kundërvënia komplementare: *përparim rrëfimor: përshkrim (rrëfimor)*, shprehur përkitazi me „kohë veprimi” e „kohë përshkrimi”. Me anë të përshkrimit a deskripcionit jepet informacion për kohën dhe hapësirën, atmosferën, rrethinën, ambientin, rrethanat në të cilat ndodhin veprimet. . . : *ishte mesditë; zhegu digjte; matanë udhës fillonin arat; përreth këndonin gjinkallat; bota dukej e topitur; kallëzat e ngacmonin; ai i largonte; (një njeri) duhej të vdiste; (ai) ecte me armën në sup. Lëvizja e rrëfimit „ndërpritet” për një çast nga një fjali e ndërkalur komentuese, duke shprehur një të dhënë plotësuese ndaj fjalisë parashkuese: *ishte (=qe) ndërhyrja e fundit e grurit*.*

Trajtat kohore të së kryerës së thjeshtë janë ato që lidhen me veprimet e njëpasnjëshme, me aksione që ndjekin njëri-tjetrin, që shtjellohen suksesivisht; me fjalë të tjera, e kryera e thjeshtë lidhet me përparimin, ecjen përpara të veprimeve: *ai eci; doli matanë; u fsheh; priti; njeriu kaloi; ai ngriti pushkën; mënjanoi disa kallëza; në shënjestër u fut koka e njeriut; ndali frymëmarrjen; shtiu; flaka përzhiti kallinjtë; njeriu u rrëzua përmbys*.

Për të dalluar dy planet shpesh përdoren nocionet *plani i parë* (trajtat perfekte): *plani i dytë* (trajtat imperfektive), solidarësia e të cilëve sajon ecurinë e *relievizimit* a të të *vënit në pah*, të *spikatjes*, siç do të thoshte H. Weinrich. Të tjerët, si D. Maingueneau, përdorin metaforën pikturale „pikturë sfondi” a „tablo”. Përgjithësisht, përkundër planit të parë, që lidhet me ecjen përpara të rrëfimit, plani i dytë ka të bëjë me përskrimin, sajuar ky për të saktësuar njëherazi karakterin, emocionet... e personazheve, për të dhënë njoftime (informacion) mbi atmosferën, identitetin e vetave dhe mbi lokalizimin hapësinor-kohor, për të komentuar etj.⁹ Për shoqërimësi e dy planeve nuk kufizohet në rrëfim, megjithëqë në këtë merr vlerë të vërtetë përdorimore; kjo komplementarësi ndërmjet trajtave perfekte dhe imperfektive vepron edhe në diskurs. Edhe në këtë trajtat e pakryerisë grupëzohen rreth trajtave të kryerisë për t’ua themeluar këtyre sfondin, bazën e incidencës, tablonë, pikturën, dekorin, për të komentuar... Bashkimet e tyre sajojnë njësi tekstore koherente brenda tërësisë me të madhe, më të gjerë; në ligjërimin e folur përgjithësisht kjo bashkuarsi nuk tejkalon kuadrin fjalior, duke mbetur kështu në kufijtë e perspektivës *aspekt i kryer: aspekt i pakryer*. Ecuria e *relievizimit* a e *spikatjes* vepron edhe në ato njësi tekstore të cilat paraqitja e ngjarjeve bëhet nga veta e parë, që mund të përfaqësojë vetë autorin, dikë tjetër, një personazh të veprës letrare. Në këtë teknikë shkrimi shumë herë është vështirë të vihen kufij ndarës në mes të njërive tekstore të lidhura përkitazi me ligjëratën dhe rrëfimin. Në këso rastesh, duke e shoqëruar vetën e parë me folje në të kryerën e thjeshtë, sikur mëtohet t’i jepet kësaj vete statusi i një *jovet e rrëfimore*, i një *vet e narrative*, e ndryshme nga *unë* si shqiptues aktual. Në këtë „teknikë”, e kombinuar me të kryerën e thjeshtë, *unë* pothuajse del e pashoqëruar nga deiktikë dhe do të mund të zëvendësohej nga *joveta*, duke mos modifikuar në asnjë pikëpamje pjesën tjetër të tekstit.¹⁰

Përveç kalimit nga një kohë foljore në një tjetër në relievizim, që shpjegohet lehtë, ka raste të tjera përdorimi për ç’gjë duhen kërkuar kritere të tjera. Disa nga ato kalime mund të lidhen me marrëdhënien e shqiptuesit ndaj thënies së vet, të tjera me krijimin, me sajimin e tekstit.

⁹ Po ai, *po aty*, f. 66.

¹⁰ Po ai, *po aty*, f. 58.

Kalimi nga një kohë në tjetrën mund të jetë arsyeja e dallimit të rrëfimit nga ligjëratat. Kjo ecuri strukturimi tekstor përdoret për të shprehur lidhjen e shqiptuesit kundrejt thënies së tij. Në këtë rast, shqiptuesi ndërhyt si komentues, si vlerësues faktesh e ngjarjesh; për t'u përmbushur kjo, braktisen kohët foljore të rrëfimit në dobi të kohëve foljore të ligjëratës, duke u shprehur kështu lidhja (marrëdhënia) e shqiptuesit ndaj thënies së vet. Me fjalë të tjera, kalimi nga një kohë në tjetrën mund të shërbejë për të shënuar dallimin në mes narracionit dhe komentimit të ngjarjeve nga shqiptuesi. Kjo e ka burimin te kundërvënja *ligjëratë: rrëfim*.

„Populli *u shty* në rrugë. Po *vinte* çadra ngjyrë gjaku e Evrenozit. Garda *përpiqej* ta futte në Krujë të ngrehur. *Ishte* sikur *po hynte* vetë qyteti i Stambollit. Gratë dhe fëmijët nuk *u përmbajtën* më. Asnjë ëndërr nuk *do të dukej* këtej e tutje e pabesueshme. Tani secili *mund të tregonte* çfarë *donte*. Atje e prapa *do të tregoheshin* sheshit „mrekullitë” e Skënderbeut që *do të rriteshin* në shekuj, të veshura me „prova” mallëngjyese, me „gjurmët e kalit të tij”, të mbetur në maja malesh, me „shkëmbinjtë e prerë në mes me shpatë nga ai”, me pusët, krojet, tryezat, kalatë malore të Skënderbeut, të përhapura në çdo majë e grykë duke shndërruar kështu njeriun në një legjendë të gjallë.

Në histori shumë prijës *kanë çuar* peshë imagjinatën e popujve dhe *kanë mbetur* legjendë, por *janë* fare të rrallë ata, emri dhe vepra e të cilëve *të kenë qenë lidhur* aq thellë me fatin dhe ekzistencën e një populli, siç *ngjiste* me Skëndebeun”.

Në fragmentin parashkues, nxjerrë nga romani „Skënderbeu” i S. Godos, shprehet mjaft qartë dallimi i vënë nga autori në mes të komentimit në kryerreshtin e dytë, dhënë nga e kryera, e tashmja, e pakryer dhe e kryera e mbipërbërë e lidhore dhe të rrëfimit në kryerreshtin e parë, dhënë nga e kryera e thjeshtë, e pakryera dhe e ardhmja e së shkuarës, kjo e fundit e përdorur si një prospektiv, si një kohë anticipimi, parashkimi, parathënieje, si një pseudofutur. Ky komentim mbyll kapitullin e katërt „Plaga dhe fitorja” të pjesës së dytë të këtij romani historik. Por komentimi del edhe në pozicione të tjera, zakonisht në formë thëniesh me vlerë gjenerike. Në këtë ecuri ndërthuren njëherazi kërkesa tekstore dhe thëniesimi (thënëse).

Le të marrim tashti një fragment, shkruar nga Prof. Mahir Domi, për jetën dhe veprën e Prof. A. Xhuvanit:

„Me shpalljen e Kushtetutës në Perandorinë Otomane më 23 korrik 1908, *u krijuan* mundësi për zhvillimin në mënyrë legale, të një veprimtarie kulturore e arsimore kombëtare. Problemi i organizimit të shkollës shqipe *dilte* në plan të parë. Kongresi i Elbasanit, që *zhvilloi* punimet më 2-9 shtator 1909, *vendosi* hapjen e një shkolle normale në Elbasan për formimin e kuadrit mësimor të nevojshëm dhe *caktoi* masat për ngritjen dhe mbajtjen e

saj. Drejtimi i shkollës *iu besua* patriotit të shquar, poetit dhe publicistit të njohur, Luigj Gurakuqit. Si mësues në këtë shkollë *u thirr* edhe Aleksandër Xhuvani”.

Më 1 dhjetor 1909, në mes të një entuziazmi të përgjithshëm, *hapte* dyert kjo shkollë e parë e mesme e arsimit tonë kombëtar, kjo fidanishte e edukatorëve të popullit tonë, e aktivistëve të kulturës shqiptare. . .”.

Në këtë fragment kalimi nga të kryerat e thjeshta të paragrafit të parë në të pakryerën në paragrafin vijues duhet të jetë lidhur nga autori me funksion tekstori; ky ndërrim vjen aty si një lloj shenje e dallojës tekstore për të tërhequr vëmendjen e receptuesit për një ngjarje me rëndësi kombëtare; segmentimi, prerja, dhënë nga e pakryera, thua se i përgjigjet më mirë një date me përmasa kombëtare, me dimension nacional, një etape të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar. Kështu pra, në fragmentin e mësipërm përdorimi i së pakryerës pas një vargu të kryerash të thjeshta nuk shpjegohet nga dukuria e relievizimit, e të vënit në pah, e spikatjes apo e kundërvënies së mirëfilltë aspekte; aty, njësoj si të kryerat e thjeshta, e pakryera ka të bëjë me planin e parë, çka shpjegohet, përveç të tjerash, edhe nga rrethanori kohor „më 1 dhjetor 1909”, që shënon një datim objektiv qartë të përkufizuar. Duke qenë të të njëjtit plan, ato edhe mund të ndër-këmbehen. Kjo e pakryer perfekteve nganjëherë, me pozicion që zë, sikur shënon rrjedhimin e asaj që i paraprin. Një kuptim i tillë nënvizohet më mirë nga rrethanorë kohorë të paskohësisë, si *pas pak, pak më vonë, të nesërmen, një vit më pas, dy ditë (javë, vjet), më vonë* etj. Në disa sekuenca (segmente, prerje) e *kryer e thjeshtë: e pakryer*, kjo e fundit nuk shpreh një veprim të njëkohshëm me veprimin e emërtuar nga e kryera e thjeshtë, siç ndodh në relievizim, por një veprim perfektiv paskohësie, vijues. Ndërhyrja e së pakryerës shkakton një prerje teksti, prerje e cila, me kundërvënien e sajuar, në mënyrë të veçantë shpreh a thekson më të rëndësishmin fakt a të rëndësishmet fakte. Kështu, kërkesa e sajimit, e ndërtimit të tekstit në disa nga këto sekuenca (prerje, segmentime), duhet të jetë arsyeja e ndërrimit, e kalimit nga një kohë në një tjetër. Por, përveç këtyre ndërrimeve shumë të përgjithshme, ndërrime të tjera të larmishme mund të lidhen me veçori ose tipa të caktuar tekstesh. Ndërrimet pra mund të jenë farësh të ndryshme; larmia e tyre ka rjedhoja a ndikimi në rëndësinë e segmentimit, të *prerjesisë* që synohet nga emetuesi; ndërrimi mund të jetë, siç u pa, motivi i kalimit nga rrëfimi në ligjëratë, por mund të jetë edhe si motiv kalimi nga ligjëratë në rrëfim, — çka perceptohen lehtë nga receptuesi. Ndërrimi pastaj mund të jetë ndërrim i boshtit kohor: kalimi nga e tashmja në një kohë të së shkuarës ose të së ardhmes dhe kështu me radhë. Kjo ecuri ka të bëjë me ligjëratën. Por ndërrimet mund të ngjajnë dhe brenda të njëjtit bosht kohor: kalimi nga e tashmja në të tashmen peri-

frastike, nga e pakryera në të pakryerën perifrastike, nga e kryera në të kryerën e thjeshtë, nga e ardhmja me *do* në të ardhmen me *kam*. . . ; nga e kryera e thjeshtë në të pakryerën etj. Në rastin e fundit, siç u pa, kemi të bëjmë me kundërvënien *plan i parë / plan i dytë*. Rrëfimi, që mëton të ndjekë sistematikisht ecurinë e relievizimit, kohët foljore synon t'i organizojë në vargje homogjene formash të planit të parë dhe të dytë. Komplementarësia që ekziston në mes dy vargjeve, parakupton ndër këmbime të vazhdueshme planesh dhe kjo është ajo që bën të mundur përcaktimin e kufijve të mikronjësive rrëfimore.¹¹

Tafil Kelmendi

CERTAINS ASPECTS DE L'UTILISATION DES TEMPS
DU VERBE EN LANGUE ALBANAISE D'AUJOURD'HUI

Résumé

Cette étude englobe certains aspects de l'utilisation des temps verbaux en albanais. L'auteur défend le point de vue que le temps est une catégorie déictique qui permet la distinction du présent, du passé et du futur. Il permet la localisation du processus énoncé par le verbe dans le temps physique.

Les temps verbaux, hormis leurs valeurs temporelles et/ou d'aspect, se divisent en deux systèmes verbaux, liés à deux types différents et inter-complémentaires de l'énonciation: *discours/récit* ou bien à deux types de *description*: „historical” / „experiential”.

Le *discours* est en rapport avec le temps de l'énoncé, le *récit* possède des liens bien fixés avec ce temps. Les énoncés du *récit* représentent une série d'événements détachés de leur énonciateur; tout se passe comme si personne ne créait d'énoncé, comme si les événements coulaient d'eux-même. L'énonciateur est comme effacé dans le *récit*, il ne laisse pas de trace dans l'énoncé. Dans le *discours*, les traces de l'énonciateur sont partout. Donc, tandis que l'énonciateur est aussi le *je* dans le *discours*, il est indéterminé dans le *récit*, comme tout autre sujet; au lieu d'asserter, il se contente de constater (cf. D. Maingueneau, *Approche de l'énonciation en linguistique française*, Hachette, Paris 1981, p. 55, etc.). Il faut tenir compte du fait que l'effacement de tout signe d'énonciation sous-entend un contrôle strict de l'énonciateur et, indépendamment de son importance, cela peut conduire à de fausses interprétations, si la distinction *discours/récit* n'est pas saisie justement (ibid. p. 56—57).

Le *discours*, ou la manière de *description expérimentale*, est caractérisé par la présence du couple *je/tu*, tandis que le *récit* par l'absence de ce

¹¹ Po ai, *po aty*, f. 87.

Shënim. — Për këtë punim janë konsultuar edhe shumë artikuj që paraqesin interes, të shkruar në gjuhën shqipe dhe në serbokroatishte.

couple. Donc la présence de *je/tu* = discours, son absence = récit. Mais, d'après l'auteur, ce n'est pas uniquement l'absence de personne qui est le fondement du récit, ni la seule combinaison „non-personne + passé simple”. En fait, le passé simple albanais, à cause de son double statut d'utilisation, doit être employé non seulement avec la présence de la nonpersonne, mais aussi avec l'absence des „*embrayeurs*”. Combiné avec la nonpersonne, l'aoriste albanais peut donc s'accorder aussi bien avec le récit qu'avec le discours. Par contre, la combinaison „non-personne + passé composé” et l'absence du couple *je/tu* conduit d'elle-même au discours, tandis que la combinaison „non-personne + aoriste” n'est pas suffisante en elle-même pour mettre en relation l'énoncé avec l'un ou l'autre plan d'énonciation. En tant que transporteur du temps du récit, l'aoriste s'étend sur un environnement caractérisé par l'absence des personnes *je/tu*, tandis que, en tant que transporteur du discours, il s'étend sur un environnement caractérisé par la présence des personnes *je/tu*.

L'auteur s'est efforcé de définir les sens fondamentaux de l'aoriste et du parfait. L'aoriste n'est pas seulement en relation avec l'imparfait; contrairement à son opposition avec ce dernier, qui est présente aussi bien dans le discours que dans le récit, son opposition avec le parfait ne fonctionne que dans le discours. Il faut prendre le fonctionnement du parfait à l'intérieur du discours comme une donnée très importante pour la détermination et la définition de sa nature. Les deux temps mentionnés sont déictiques: le signe de détermination de leurs relations est le temps du discours; tout deux sont employés avec des indicatifs de temps qui sont en relation directe avec le temps de l'énonciation et, en particulier, l'aoriste avec l'indicatif *tash* (maintenant)? Ils concordent avec un déictique comme *dje* (hier), comme du point *R*, antérieure à *S*, et avec le déictique *tash* comme incorporateur *die* (hier), comme du point *R*, antérieure à *S*, et avec le déictique *tash* comme incorporateur du point *R*, simultané à *S*. Il n'y a aucune contrainte dans la combinaison de ces temps avec le déictique *dje* en albanais; tout deux sont ouverts à ce „jeu” de combinaison. Ainsi, si on utilise le système référentiel de Reichenbach, dans ce cas nous avons *ER-S*, l'évènement (*E*) et le point de référence (*R*) s'accordent et sont en rapport d'antériorité avec le temps de l'énonciation (*S*); dans le second cas, nous avons *E-RS*, l'évènement (*E*) est en relation d'antériorité avec le point d'orientation (*R*) et le temps de l'énonciation qui s'accordent entre eux. Mais, le temps de l'évènement peut aussi servir de signe de distinction de leurs rapports si l'on prend *atëherë* (alors) pour base comme source temporelle en profondeur dans le passé. Cependant, cette manière d'analyse et d'interprétation ne doit point à la confusion entre la valeur temporelle et le système de référence qui le détermine. Tout bien considéré, l'information que donne le parfait et l'aoriste est celle-ci : le processus énoncé par le verbe à ces temps se déroule dans un temps antérieur à celui de l'énonciation. La référence déictique est exprimée pratiquement dans une même mesure que les deux temps mentionnés.

La composante de l'allongement, de l'étendue d'une action passée dans le temps, sa perception comme un intervalle déterminé, ou l'observation d'un état acquis d'une action passée caractérisent le parfait. La différence

fondamentale entre le parfait et l'aoriste albanais est: dans le premier, l'action est présentée comme un état acquis par son passé ou bien comme un certain allongement dans le temps (avec des limites temporelles déterminées; le second constate la fin d'une action perçue comme un ensemble dont l'aboutissement est saisi comme un point à un moment bien déterminé; il considère l'action dans un moment, un point fixé, momentané, subit, clairement déterminé et délimité, saisi à son aboutissement (ou à son commencement). L'aoriste exprime une situation dynamique comme un fait, un événement. Ainsi, donc, l'aoriste est lié fondamentalement avec les événements fixés sur des points déterminés, tandis que le parfait avec des processus prolongés dans une certaine période, ou bien avec des situations obtenues par des actions passées; celui-ci saisit l'action passée au cours de toutes les phases de déroulement, dans un prolongement relatif et dans une étendue temporelle déterminée. Souvent, l'aoriste est défini comme un temps d'actions passées et consécutives, ou bien comme un temps du récit, tandis que le parfait comme un temps exprimant une action relevante dans un moment antérieur au temps de l'énonciation, soit un état acquis par une action, relevant à ce moment, ou un passé exprimant l'action dans le passé ou bien un état dans le présent. Ce double aspect sémantique du parfait n'est pas sans relation avec le mode de l'action, du verbe même, avec le contexte et avec les circonstances du discours.

Le fonctionnement des temps verbaux n'est pas limité uniquement dans la proposition (simple ou complexe); les temps verbaux fonctionnent également au sein d'unités transphrastiques; en plus de leur fonctionnement déictique et de leurs divers processus dans l'énonciation, les temps verbaux, par la place qu'ils tiennent dans le texte, par leur répétition, par le passage de l'un à l'autre, etc. — ont souvent une grande importance dans la structuration du texte. Leur fonctionnement au sein du texte apparaît assez clairement, en particulier dans le *processus de la mise en relief*, dans leur emploi complémentaire *parfait/imparfait*, comme temps de *premier plan* et *d'arrière plan*, en mettant, ainsi, en évidence l'opposition entre les temps verbaux de „l'action” et ceux de la „description”; dans cet emploi, l'aoriste et l'imparfait dépassent les limites de la perspective de l'aspect simple du commentaire et le récit suit, alors, systématiquement le processus de la mise en relief — par le groupement en séries homogènes des formes temporelles (d'une part au passé simple et d'autre part à l'imparfait). Les formes du parfait présentent le dynamisme, la vitalité des actions successives du récit, en le mettant en mouvement, en le faisant progresser; au contraire, les formes en *-(n)te*, *-(h)ej* stoppent le récit, le ralentissent au profit de la description pour donner tout ce qui est statique, en comparaison avec le dynamisme. Les formes en *-(n)te*, *-(h)ej* constituent l'image, le tableau, le fond où se déroulent les actions données par les formes en *-i/u-0*. On obtient ainsi l'opposition complémentaire: *progression du récit / description* (du récit), exprimée par „les temps d'action” et „les temps de description”. La description donne des informations sur le temps et l'espace, l'atmosphère, l'environnement, l'ambiance et les circonstances dans lesquelles ont lieu les actions.

Shqipërisë nuk u sigurua edhe integriteti i saj, prandaj çështja e formimit apo e sforcimit të vetëdijes kombëtare ishte ende temë preokupimi e shkrimtarëve shqiptarë, meqë e shihnin rrezikun e copëtimit e të pavarësisë së Shqipërisë, prandaj e panë të arsyeshme të vazhdojnë rrugën e letërsisë së Rilindjes për të mobilizuar masën, për të mbajtur të zgjuar vigjilencën për mbrojtjen e vendit nga synimet okupuese të qeverive të huaja borgjeze. Në këtë kohë, kur mund të pritej që realizimi, i filluar vite më parë në letërsinë shqipe, të bënte shtegun kryesor, filluan të ndihen edhe tone të tjera, që në letërsinë evropiane i kanë paraprirë romantizmit, madje edhe pseudoklasicismit, si, për shembull, në letërsinë angleze. Këto tone janë tonet e letërsisë sentimentaliste, që në lartësinë shqipe u manifestuan në prozë. Edhe në këtë pikëpamje, letërsia shqipe dallon nga ajo evropiane. Derisa, për shembull, në letërsinë angleze sentimentalizmi është më i theksuar në poezi, në letërsinë shqipe realizohet në epikën prozaikë dhe, më pak, në dramë. Megjithatë, shenjat e sentimentalizmit në letërsinë shqipe duken edhe më parë — në veprat e Muhamet Çamit, në „Erveheja” e në „Jusufi e Zelihaja” dhe, më pak, në veprat e De Radës, sidomos në veprën „Këngët e Milosaos”. Sentimentalizmi shqiptar nuk ka shumë përfaqësues dhe nuk arriti të formojë bazë teorike e as shkollë letrare. Përfaqësuesit kryesorë të sentimentalizmit në letërsinë shqipe janë, kush më pak e kush më shumë, autorët e parë të prozës shqipe, si p.sh. Ndoc Nikaj, Mihal Grameno, Foqion Postoli, Filip Papajani-Lipi, Milto Sotir Gurra, e, sidomos, Haki Stërmilli.

Kushtet politike, ekonomike e shoqërore në një kohë të caktuar kushtëzuan paraqitjen e sentimentalizmit në letërsinë shqipe më vonë se në letërsinë e popujve të tjerë. Problemet e shumta në shoqërinë e shtetit të ri shqiptar pritnin transformimin artistik. Stërmilli e ndiente obligim të merrej me të dhe të ndikonte në përmirësimin e raporteve shoqërore duke u mbështetur më shumë në ndjenjat e përjetimit të realitetit shoqëror. Kështu, mendimet liridashëse e demokratike dhe flijimi për to, nderi familjar dhe i bashkëshortësisë, dashuria e besnikëria në mes të të dashuruarve, miqësia, virtyti, urtësia, maturia, dënimi i veseve, dashuria ndaj njeriut e natyrës, paraqitja e njerëzve naivë e të ndershëm, jeta intime, emocionet e përjetimet, shprehja patetike, dominimi i ndjenjës mbi arsyen, ofshamet, sëmundjet e vdekjet e shpeshta nga pikëllimi janë elemente që e karakterizojnë prozën tregimtare të Stërmillit, dramën e para të tij dhe romanin „Sikur t’isha djalë”. Prandaj, zgjedhja e temave, zgjedhja e problemeve, zgjedhja e personazheve e fati i tyre dhe forma e trajtimit letrar në tregimet e Stërmillit janë tipike për letërsinë sentimentaliste.

Stërmilli ka besim të madh në rolin e letërsisë në shoqëri dhe këtë rol e sheh edhe më të madh nëse me krijimin letrar preken, në rend të parë, emocionet, prandaj përpiqet t’u bie atyre telave,